Statistikat e Hotelerisë dhe Turizmit në Kosovë, për periudhën 2021-2025 dhe janar-qershor të vitit 2026

1. Hyrje

Ky raport ofron një analizë të sektorit të hotelerisë dhe turizmit në Kosovë për periudhën 2021-2025 dhe për gjashtëmujorin e parë, janar-qershor të vitit 2026.


Të dhënat dëshmojnë një rritje të qëndrueshme të kapaciteteve akomoduese, me përqendrim të lartë në kryeqytet dhe një rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve dhe netëqendrimeve ndër vite. Vizitorët nga Shqipëria, Gjermania dhe Zvicra mbajnë peshën kryesore të fluksit turistik. Prishtina, Peja dhe Prizreni dominojnë si rajonet me përqendrimin më të lartë të kapaciteteve akomoduese, njësive hoteliere dhe ofertës për fjetje.

Raporti synon të nxjerrë në pah jo vetëm treguesit kuantitativë të rritjes së sektorit të hotelerisë, por edhe dinamikat rajonale e ndryshimet sezonale që ndikojnë në qëndrueshmërinë ekonomike të turizmit në Kosovë.

2. Statistikat e hotelerisë dhe turizmit, numri i vizitorëve dhe netëqëndrimet, për janar-qershor 2022-2026

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), gjatë periudhës janar-qershor 2022-2026, numri i vizitorëve dhe netëqëndrimeve ka shënuar rritje të konsiderueshme deri në vitin 2025, por në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 vërehet një rënie.


Figura 1. Numri i vizitorëve dhe netëqëndrimet për periudhën janar-qershor të vitit 2022-2026



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),
https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Tourism%20and%20hotels__Treguesit%20mujor%C3%AB/tab01.px/

Rënia prej rreth 10.6% e numrit të vizitorëve në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 sinjalizon nevojën për analizë të mëtejshme mbi ndikimin e liberalizimit të vizave, luhatjeve ekonomike dhe ofertave konkurruese rajonale.

Figura 2. Numri i vizitorëve vendor e të jashtëm në %, janar-qershor 2022-2026



Në gjashtëmujorin e parë te vitit 2026 numri i vizitorëve në Kosovë ishte 376,683 vizitorë, prej tyre vizitorë vendorë ishin rreth 152 mijë (apo 40.3%) te vizitorëve dhe të jashtëm rreth 225 mijë (apo 59.7%) te vizitorëve.

Numri i netëqëndrimet ndoqën një trend të ngjashëm, duke arritur pikun në gjashtëmujorin e parë në vitin 2023 me 922,420 netëqëndrime dhe duke rënë në 803,105 netëqëndrime në vitin 2026 prej tyre rreth 369 mijë (apo 46.0 %) netëqëndrime nga vizitorët e brendshëm dhe 434 mijë (apo 54.0%) netëqëndrime nga vizitorët e jashtëm, kjo paraqet një rënie për rreth 10.7 % të numrit të përgjithshëm të netëqëndrime.

Analizuar sipas regjioneve gjatë periudhës janar-qershor 2026, rajoni i Prishtinës udhëhoqi me numrin më të madh të vizitorëve (35.9%), ndërsa rajoni i Pejës pati përqindjen më të lartë të netëqëndrime totale (38.2%). Regjioni i Gjakovës shënoi pjesëmarrjen më të ulët në turizëm për këtë periudhë, me vetëm 2.2% të vizitorëve dhe 1.8% të netëqëndrime.

Tabela 1. Numri i vizitorëve dhe netëqëndrimet (vendor dhe të jashtëm) dhe struktura në %, sipas Regjioneve në Kosovë, për periudhën janar-qershor 2026

Janar - Qershor 2026	Gjithsej		Vendor		Të jashtëm	
	Vizitorët	*Netëqëndrimet*	*Vizitorët*	*Netëqëndrimet*	*Vizitorët*	*Netëqëndrimet*
Gjakovë	8,147	14,727	1,738	2,811	6,410	11,917
Gjilan	15,807	65,151	11,952	55,941	3,855	9,209
Mitrovicë	27,443	37,030	9,837	13,367	17,607	23,663
Pejë	96,554	306,816	52,207	176,708	44,346	130,107
Prizren	69,797	122,239	20,695	38,770	49,104	83,470
Prishtinë	135,239	216,880	42,538	62,154	92,700	154,725
Ferizaj	23,696	40,262	12,704	19,533	10,992	20,729
Gjithsej	**376,683**	**803,105**	**151,671**	**369,284**	**225,014**	**433,820**
Gjithsej në %	***100.0%***	***100.0%***	***40.3%***	***46.0%***	***59.7%***	***54.0%***
në % Gjakovë	*2.2%*	*1.8%*	*1.1%*	*0.8%*	*2.8%*	*2.7%*
në % Gjilan	*4.2%*	*8.1%*	*7.9%*	*15.1%*	*1.7%*	*2.1%*
në % Mitrovicë	*7.3%*	*4.6%*	*6.5%*	*3.6%*	*7.8%*	*5.5%*
në % Pejë	*25.6%*	*38.2%*	*34.4%*	*47.9%*	*19.7%*	*30.0%*

në % Prizren	*18.5%*	*15.2%*	*13.6%*	*10.5%*	*21.8%*	*19.2%*
në % Prishtinë	*35.9%*	*27.0%*	*28.0%*	*16.8%*	*41.2%*	*35.7%*
në % Ferizaj	*6.3%*	*5.0%*	*8.4%*	*5.3%*	*4.9%*	*4.8%*

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),
https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Tourism%20and%20hotels__Treguesit%20mujor%C3%AB/tab01.px/




Figura 3. Numri i vizitorëve jashtëm sipas shteteve nga vijnë, janar-qershor 2026

Analizuar strukturën e vizitorëve të jashtëm sipas shteteve të origjinës nga vijnë për periudhën janar-qershor 2026, Shqipëria mban vendin e parë me 26.5% të totalit, Gjermania renditet e dytë me 10.4%, e ndjekur nga Turqia me 8.9%, Zvicra me 8.4%, Maqedoniae V. me 4.4%. Shtetet e tjera më pak të specifikuara përbëjnë së bashku pjesën më të madhe të mbetur prej 41.4% të këtij tregu.

3. Statistikat e hotelerisë dhe turizmit, numri i vizitorëve dhe netëqëndrimet, 2021-2025

Në periudhën 2021-2025, turizmi hyrës ka shënuar trend të vazhdueshëm rritës, (vizitorë vendorë dhe të jashtëm) numri i vizitorëve është rritur nga 355,142 në 762,836 vizitorë, ndërsa netëqëndrimet nga 580,203 arriten në 1,653,389.

Figura 4. Numri i vizitorëve dhe netëqëndrimet gjithsej (vendor dhe të jashtëm) për vitet 2021-2025



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Tabela vazhdim paraqet numri total të vizitorëve dhe netëqëndrimet (vendor dhe të jashtëm) sipas regjioneve gjatë viteve 2021-2025. Regjioni Prishtina, Peja dhe Prizreni kanë pritur historikisht numrin më të madh rreth 80% të vizitorëve dhe rreth 81% të netëqëndrimet, kjo tregon rritjen e atraktivitetit për vizitorët e huaj e vendore dhe zgjerimin e aktivitetit në sektorin e hotelerisë dhe turizmit për këto regjione.

Tabela 2. Numri i vizitorëve dhe netëqëndrimet gjithsej(vendor dhe të jashtëm) sipas regjioneve, vitet 2021-2025


Viti	2025		2024		2023		2022		2021	
Regjioni	Vizitorë	Netët	Vizitorë	Netët	Vizitorë	Netët	Vizitorë	Netët	Vizitorë	Netët
Gjakovë	13,776	27,042	12,844	24,276	13,021	27,552	5,270	9,399	4,751	8,134
Gjilan	34,666	155,562	43,609	151,433	40,471	195,510	15,531	21,357	11,698	15,870
Mitrovicë	40,243	51,394	36,847	50,019	39,099	48,766	31,317	31,817	30,593	32,804
Pejë	201,711	607,127	203,074	591,673	153,803	659,948	74,022	222,680	72,581	161,033
Prizren	169,522	303,766	146,174	263,393	149,312	226,564	103,246	144,495	77,150	101,983
Prishtinë	261,110	425,427	205,405	341,685	175,604	305,601	190,947	322,446	134,362	220,661
Ferizaj	41,808	83,071	50,115	100,411	50,177	83,521	40,135	66,639	24,007	39,718
Gjithsej	**762,836**	**1,653,389**	**698,068**	**1,522,890**	**621,487**	**1,547,462**	**460,468**	**818,833**	**355,142**	**580,203**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

3.1. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëqëndrimet sipas shtetit nga vijnë, 2021-2025

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), vizitorët vijnë kryesisht nga vendet e rajonit dhe diaspora, trendi paraqet një rritje të vazhdueshme të turizmit ndërkombëtar në Kosovë nga viti 2021 deri në vitin 2025. Numri total i vizitorëve të jashtëm u rrit nga 212,842 në 463,092. Paralelisht, netëqëndrimet e tyre gati u trefishuan, duke u rritur nga 357,800 netë në vitin 2021 në 902,666 netë në vitin 2025.

Figura 5. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëqëndrimet, për vitet 2021-2025



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Gjatë të gjitha viteve, vizitorët nga Shqipëria dhe Gjermania prijnë bindshëm si në numër vizitash, ashtu edhe në ditë qëndrimi. Shqipëria është grupi më i madh me rreth 25.0% të totalit të vizitorëve dhe rreth 23% të të totalit të netëqëndrime, Gjermania renditet e dyta me rreth 11% të vizitorëve dhe rreth 12% të netëqëndrime, pasuar nga Zvicra me rreth 9% të vizitorëve dhe rreth 8% të netëqëndrime, Turqia me rreth 8% të vizitorëve dhe rreth 6% të netëqëndrime. Vende të tjera me ndikim përfshijnë Maqedoninë e Veriut me rreth 5%, SHBA-në me rreth 4% dhe Malin e Zi dhe Serbia me nga rreth 3%.

Tabelat në vijim ofrojnë një përmbledhje të detajuar, të numrit i vizitorëve të jashtëm dhe netëqëndrimet në Kosovës nëpër vite sipas vendeve nga vijnë. Të dhënat në *numer/vizitorë /netët,* mundësojnë analizimin e tendencave, orientimin turistik për në Kosovës gjatë viteve të fundit.

Tabela 3. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëqëndrimet sipas Shteteve, vitet 2021-2025

	2025		2024		2023		2022		2021	
Vendi / Viti	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**
Austria	9,633	18,310	10,480	19,193	9,215	16,295	8,041	13,566	6,787	11,169
Belgjika	6,831	14,681	6,070	11,481	5,182	10,726	4,508	7,571	3,827	7,635
Bosna e Hercegovin	3,900	6,740	1,808	2,909	1,759	3,229	2,086	4,402	1,395	2,127
Britania e Madhe	10,569	17,041	9,190	16,665	8,421	16,938	7,847	13,401	5,197	7,772
Franca	9,973	17,143	8,666	14,293	7,342	12,281	5,698	8,986	3,664	5,687
Gjermania	52,602	105,850	46,775	100,471	41,105	98,156	34,521	68,707	25,671	52,435
Greqia	4,365	7,292	3,803	6,364	2,841	4,471	2,254	4,942	1,723	2,569
Holanda	5,503	12,547	4,534	8,284	4,624	8,705	3,208	5,591	1,726	2,946
Italia	11,707	20,355	11,817	21,943	11,164	24,963	8,261	19,879	5,625	15,108
Kroacia	11,726	16,733	9,587	18,267	7,733	15,457	6,628	12,857	9,128	18,417
Mali i Zi	11,595	47,403	10,188	38,231	8,741	30,504	5,597	8,012	3,595	5,763
Maqedonia	21,074	48,654	19,023	39,989	17,024	40,194	11,948	17,054	8,874	12,545
Polonia	9,196	10,470	3,841	4,930	4,034	5,561	2,230	3,501	1,448	2,547
Serbia	12,464	27,569	9,205	21,443	9,354	21,478	9,617	15,538	8,006	13,459
SHBA	15,698	27,702	19,543	35,852	15,780	27,607	13,180	24,311	8,433	13,500
Shqipëria	116,444	213,402	109,330	204,262	90,518	191,575	63,775	107,691	55,591	75,887
Sllovenia	3,266	6,049	4,137	7,491	3,851	7,229	3,664	5,984	2,878	5,233
Spanja	4,469	7,995	4,648	7,249	3,886	6,164	1,833	5,754	1,453	2,492
Turqia	35,760	57,411	32,152	51,497	23,482	40,315	17,490	27,917	10,907	19,049
Zvicra	40,941	69,970	37,588	69,645	36,812	78,889	28,211	49,270	24,719	40,193
Të tjera	65,375	149,349	60,897	127,492	44,849	85,765	56,990	119,767	22,195	41,267
Gjithsej	**463,092**	**902,666**	**423,282**	**827,951**	**357,717**	**746,502**	**297,587**	**544,701**	**212,842**	**357,800**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),
https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Tourism%20and%20hotels__Treguesit%20vjetor/ht05.px/

3.2. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëqëndrimet sipas regjionit vitet 2021-2025

Sipas shpërndarjes rajonale gjatë viteve 2021-2025, Prishtina dhe Prizreni kanë pritur historikisht numrin më të madh të vizitorëve të jashtëm, ndërsa rajoni i Pejës mbetet jashtëzakonisht lartë në kapacitetet e qëndrimit, duke regjistruar 270,696 netëqëndrime në vitin 2025, shifër që i afrohet kryeqytetit. Nga ana tjetër, rajonet si Mitrovica, Ferizaj, Gjakova dhe Gjilani, ndonëse kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2021, mbeten zonat më pak të vizituara nga ndërkombëtarët.


Tabela 4. Numri i vizitorëve të jashtëm dhe netëqëndrimet e tyre nëpër regjionet e Kosovës, vitet 2021-2025

Viti	2025		2024		2023		2022		2021	
Regjioni	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**	**Vizitorët**	**Netët**
Gjakovë	10,635	21,566	9,486	18,892	8,755	17,749	4,008	7,514	3,123	5,670
Gjilan	9,537	21,888	13,067	29,912	7,469	19,336	5,374	9,935	5,403	8,502
Mitrovicë	27,476	34,588	21,460	29,022	19,997	24,586	16,437	16,908	18,767	19,972
Pejë	96,597	270,696	89,214	232,625	67,333	250,654	42,594	121,212	33,646	79,452
Prizren	113,373	195,124	100,428	181,709	95,297	136,280	61,343	88,959	45,396	60,800
Prishtinë	184,937	316,736	165,426	284,222	136,960	246,733	152,387	265,379	98,573	165,563
Ferizaj	20,539	42,068	24,201	51,568	21,907	51,161	15,446	34,794	7,936	17,841
Gjithsej	**463,092**	**902,666**	**423,282**	**827,950**	**357,717**	**746,499**	**297,587**	**544,701**	**212,842**	**357,800**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Nëse analizojmë strukturën dhe përqindjen e vizitorëve të jashtëm sipas regjioneve për vitin 2025, del se Prishtina dominon si pika kryesore strategjike me 39.9% të vizitave, pasuar Prizreni si destinacioni i dytë më i preferuar me 24.5%, i ndjekur nga Peja me 20.9%, ndërsa katër rajonet e tjera (Mitrovica, Ferizaj, Gjakova dhe Gjilani) ndajnë së bashku vetëm rreth 14.7% të pjesës së mbetur të vizitorëve të jashtëm.

Figura 6. Numri i vizitorëve jashtëm nëpër **regjionet** e Kosovës në %, vitin 2025,




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

4. Kapaciteteve akomoduese në Kosovë sipas llojit dhe njësive të akomodimit, vitet 2021-2025

Sektori hotelerisë dhe turizmit ka shënuar një zgjerim të vazhdueshëm të kapaciteteve totale akomoduese gjatë periudhës pesëvjeçare.

Dominimi i Hoteleve mbetet lloji kryesor i akomodimit, duke arritur në 288 njësi në vitin 2025 me 7,291 dhoma, e me 15,156 shtretër, që paraqet 51.9% të strukturës përgjithshme të akomodimit, Motelet renditen të dytat me 173 njësi në vitin 2025, me 2,031 dhoma, e me 4,054 shtretër, që paraqet 31.2% të strukturës te përgjithshme të kapaciteteve akomoduese në vitin 2025.


Figura 7. Kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas **llojit** dhe njësive të akomodimit 2025



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Nëse analizojm sipas llojit të akomodimit dhe numrit të shtretërve, shohim se kapacitetet akomoduse janë rritur nga 499 sa ishin në vitin 2021 në 555 njësi në vitin 2025, numri i dhomave u rrit nga 7,551 në 10,010 dhoma (në vitin 2025), ndërsa numri i shtretërve pothuajse u dyfishua, duke shkuar nga 11,811 në 20,922 shtretër (në vitin 2025).

Figura 8. Kapacitetet hoteliere 2025 në %, sipas llojit të akomodimit dhe **numrit të shtretërve**



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

Tabelat në vijim ofrojnë një përmbledhje të detajuar të kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas llojeve të njësive të akomodimit, numrin e dhomave dhe shtretërve, gjatë viteve të fundit.

Tabela 5. Kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas llojit të akomodimit, llojet e njësive të akomodimit për vitet 2021 deri 2025

Llojit të akomodimit	numri/viti	2025	2024	2023	2022	2021
Apartamente	Nr.njësive	15	15	15	15	15
	Dhoma	25	25	25	25	25
	Shtretër	50	50	50	32	32
Bujtina	Nr.njësive	22	11	11	12	12
	Dhoma	184	53	53	60	60
	Shtretër	443	128	128	129	129
Bungallo	Nr.njësive	44	42	43	41	41
	Dhoma	419	391	403	374	374
	Shtretër	1,000	945	969	768	768
Hostele	Nr.njësive	13	12	12	13	13
	Dhoma	60	55	55	59	59
	Shtretër	219	206	205	218	218
Hotele	Nr.njësive	288	277	257	239	239
	Dhoma	7,291	7,158	6,610	4,873	4,873
	Shtretër	15,156	14,904	13,843	7,790	7,790
Motele	Nr.njësive	173	172	174	179	179
	Dhoma	2,031	2,023	2,047	2,160	2,160
	Shtretër	4,054	4,038	4,090	2,874	2,874
Gjithsej	**Nr.njësive**	**555**	**529**	**512**	**499**	**499**
	Dhoma	**10,010**	**9,705**	**9,193**	**7,551**	**7,551**
	Shtretër	**20,922**	**20,271**	**19,285**	**11,811**	**11,811**

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Tourism%20and%20hotels__Treguesit%20vjetor/ht01.px/

Bazuar në të dhënat vjetore të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), numri i hoteleve dhe shtretërve në Kosovë ka pësuar një rritje të vazhdueshme dhe të ndjeshme nga viti 2021 deri në vitin 2025.


Numri i hoteleve shënoi rritje për rreth 21%, respektivisht me rreth 50% rritje e kapaciteti të dhomave, nga 239 hotele me 4,873 dhoma sa ishte në vitin 2021, në vitin 2025 arrin 288 hotele me 7,291 dhoma. Ndërsa numri shtretërve në hotele ka shënuar një rritje te madhe prej 94.6%, nga 7,790 shtretër sa ishin në vitin 2021, gati u dyfishua në vitin 2025 duke arritur në me gjithsej 15,156 shtretër.

Nëse marrim parasysh, kapaciteti i përgjithshëm për të gjitha llojet e njësive akomoduese (hotele, motele, apartamente, bujtina, etj.), trendi është në rritje si vijon: (i) njësitë totale janë rritur nga 499 njësi në vitin 2021 në 555 njësi në vitin 2025, (ii) shtretërit në total, kapaciteti i përgjithshëm u rrit me 77.1% duke shkuar nga 11,811 shtretër në vitin 2021 në 20,922 shtretër në vitin 2025.

5. Kapaciteteve akomoduese në Kosovë, shpërndarja regjionale, vitet 2021-2025

Bazuar në të dhënat vjetore, kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas regjionit për vitin 2025, Rajoni i Prishtinës ka kapacitetin më të madh të njësive akomodues në Kosovë, duke udhëhequr në të gjitha kategoritë e matshme, pas tij vijnë rajonet e Pejës dhe Prizrenit.

Figura 9. Kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas regjionit, sipas njësive të akomodimit 2025, në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Regjioni i Prishtinës në vitin 2025, përbën qendrën kryesore me 176 njësi akomoduese (31.7% e totalit në vend), duke ofruar 3,255 dhoma dhe 6,206 shtretër apo 29.7% e kapacitetit të përgjithshëm.

Regjioni i Pejës (2025), renditet e dyta me 118 njësi akomoduese (21.3%), 2,059 dhoma dhe 4,380 shtretër apo 20.9% e kapacitetit të përgjithshëm.

Regjioni i Prizrenit (2025), renditet i treti me 97 njësi akomoduese (17.5%), 1,506 dhoma dhe 3,230 shtretër apo 15.4% e kapacitetit të përgjithshëm.

Regjioni i Ferizajt (2025), renditet ne vijim me 58 njësi akomoduese (10.5%), 742 dhoma dhe 1,434 shtretër apo 6,9% e kapacitetit të përgjithshëm.

Në vitin 2025, Regjioni i Gjilanit, disponon 39 njësi akomoduese, por me rreth 3,760 shtretër apo rreth 18% e kapacitetit të përgjithshëm, regjionet e tjera që kanë kapacitete më të vogla janë Mitrovica me 33 njësi akomoduese me 1,084 shtretër dhe Gjakova me 34 njësi akomoduese e me 828 shtretër, kanë kapacitetet më të ulëta akomoduese (me 5.2%, respektivisht rreth 4.0%).

Dallimi midis përqendrimit të njësive akomoduese në kryeqytet dhe kohëqëndrimit më të gjatë të vizitorëve në rajonet natyrore si Peja nënshtron nevojën për investime strategjike në turizmin malor dhe kulturor.

Tabelat në vijim ofrojnë një përmbledhje të detajuar të kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas regjioneve, sipas llojeve të njësive të akomodimit, numrin e dhomave dhe shtretërve, gjatë viteve të 2021-2025 dhe struktura në përqindje (%) për vitin 2025.

Tabela 6. Kapacitetet hoteliere në Kosovë sipas regjionit, për vitet 2021 deri 2025 dhe struktura në përqindje (%) për vitin 2025

Viti	Numri/ Regjioni	Gjakova	Gjilani	Mitrovica	Peja	Prizreni	Prishtina	Ferizaj	Gjithsej
2025	Nr.njësive	34	39	33	118	97	176	58	**555**
	Dhoma	434	1465	549	2059	1506	3255	742	**10,010**
	Shtretër	828	3760	1084	4380	3230	6206	1434	**20,922**
2024	Nr.njësive	30	39	33	103	99	167	58	**529**
	Dhoma	404	1465	549	1870	1519	3156	742	**9,705**
	Shtretër	768	3760	1084	3934	3255	6036	1434	**20,271**
2023	Nr.njësive	30	39	33	99	95	158	58	**512**
	Dhoma	404	1465	549	1746	1460	2827	742	**9,193**
	Shtretër	768	3760	1084	3701	3,112	5,427	1,434	**19,285**
2022	Nr.njësive	29	35	29	93	88	161	64	**499**
	Dhoma	374	490	484	1235	1297	2785	886	**7,551**
	Shtretër	513	717	734	2327	2593	3791	1136	**11,811**
2021	Nr.njësive	29	35	29	93	88	161	64	**499**
	Dhoma	374	490	484	1,235	1,297	2,785	886	**7,551**
	Shtretër	513	717	734	2,327	2,593	3,791	1,136	**11,811**
Struktura si % gjendja në vitin2025	***Nr.njësive***	***6.1%***	***7.0%***	***5.9%***	***21.3%***	***17.5%***	***31.7%***	***10.5%***	***100%***
	Dhoma	***4.3%***	***14.6%***	***5.5%***	***20.6%***	***15.0%***	***32.5%***	***7.4%***	***100%***
	Shtretër	***4.0%***	***18.0%***	***5.2%***	***20.9%***	***15.4%***	***29.7%***	***6.9%***	***100%***

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Tourism%20and%20hotels__Treguesit%20vjetor/ht02.px/